



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE
 Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 781
 Datë: 22/05/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Mekatronikë
Titulli i punimit	Projektimi, konfigurimi dhe automatizimi i një sistemi të shiritit transportues me PLC <i>Angl. Design, configuration and automation of a conveyor belt system with PLC</i>
Kandidati	Bsc. Besnik Vuça
Mentori	Prof. dr. Mirlind Bruçi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 19.05.2025 Vendimi Nr.: 727

Vlerësimi i dorëshkrimit.

Punimi (dorëshkrimi i punimit) me titull: **“Projektimi, konfigurimi dhe automatizimi i një sistemi të shiritit transportues me PLC”**, e kandidatit Besnik Vuça, *bachelor*, është punuar në gjithsej 74 faqe tekst të formatit A4, në vazhdim të cilës është dhënë deklarata studentit për punë autentike dhe shtojca e bashkangjitur. Në kuadër të tekstit janë përfshirë figura dhe tabela. Punimi është strukturuar në 5 kapituj se bashku me përfundimin dhe literaturën e shfrytëzuar me 23 njësi bibliografike. Metodologjia e përdorur për strukturimin e punimit është e konceptuar mbi baza shkencore dhe shumë të përshtatshme edhe nga ana praktike dhe didaktike. Shtjellimi i punimit për secilin kapitull është bërë me kujdes, si dhe në mënyrë profesionale dhe shkencore.

Si rast hulumtimi është përzgjedhur një automatizim i procesit të një sistemi tek shiritat transportues, ku si qëllim e ka të përfshijë projektimi, konfigurimin, të analizoj funksionin, rendësin e projektit të automatizuar me PLC (Programmable Logic Controller - Kontrollues Logjike të Programueshëm), pastaj njohja me paketën e softuerit TIA PORTAL të Siemens, i cili ofron mjetet e nevojshme për të zhvilluar automatizim të thjeshtë ose kompleks me PLC dhe krijimin e projektit të automatizuar me shirita transportues.

Proceset prodhuese të automatizuara në industri përfshijnë ndërtimin, aplikimin dhe simulimin e projektit për drejtimin e një sektori me shirita transportues nëpërmjet PLC-ve, ku është programuar në gjuhën e programimit Ladder dhe është zhvilluar një HMI (Human Machine Interface) për të kontrolluar aplikacionin, duke përdorur mjetet STEP 7, PLC-SIM dhe WinCC të përfshira në paketën e softuerit TIA PORTAL të Siemens.

Formulari – F2

Në projektin e ndërtuar është prezantuar programi i krijuar me PLC, ku fillimisht përshkruhet funksionimi i një shiriti transportues në të cilin vendosen shishe për tu transportuar drejt kutive të paketimit pas një numri të përcaktuar që duhet për secilën kuti. Pasi përfundon mbushja e kutisë, shiriti i shisheve ndalon dhe aktivizohet krahu robotik i cili zhvendos kutin dhe pasi përfundon zhvendosja e kutisë aktivizohet shiriti i transportit të kutive. Pasi mbërrin në pozicionin e duhur kutia boshe aktivizohet përsëri shiriti i shisheve për mbushjen e kutive.

Mbështetur në problematikën e shqyrtuar në këtë punim, komisioni është i mendimit se metodologjia e zbatuar për rastin e teknologjisë prodhimit të proceseve të automatizuara për rastin konkret linja e shiritave transportues si rast konkret në industrinë e vendore, janë prezantuar në mënyre profesionale.

Tema në fjalë paraqet një kontribut profesional dhe shkencor të kandidatit, andaj punimi i masterit me titull **“Projektimi, konfigurimi dhe automatizimi i një sistemi të shiritit transportues me PLC”**, i kandidatit BSc. Besnik Vuça, i dorëzuar për vlerësim, i përmbush kushtet dhe kriteret e një punimi të masterit.

Konkluzioni i Komisionit

Në bazë të vlerësimit të punimit të masterit me titull: **“Projektimi, konfigurimi dhe automatizimi i një sistemi të shiritit transportues me PLC”**, e kandidatit BSc. Besnik Vuça.

Komisioni sjellë këtë

K o n k l u z i o n

Punimi i masterit me titull **“Projektimi, konfigurimi dhe automatizimi i një sistemi të shiritit transportues me PLC”**, i kandidatit BSc. Besnik Vuça, i përmbush parakushtet metodologjike, profesionale-shkencore dhe etike si temë për punim të masterit. Punimit i është bashkëngjitur edhe Deklarata e studentit për punë autentike.

Prandaj, në mbështetje të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në mbështetje të Rregullores për studime master, Komisioni për vlerësim, unanimisht dhe me kënaqësi i:

P r o p o z o n

Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, të miratojë Raportin për vlerësimin e punimit për master me titull **“Projektimi, konfigurimi dhe automatizimi i një sistemi të shiritit transportues me PLC”**, i kandidatit BSc. Besnik Vuça, dhe të bëjë procedimin e mëtejshëm, përkatësisht të formojë Komisionin për mbrojtje dhe të caktojë datën për mbrojtje publike të punimit.


Prishtinë: 21/05/2025

Komisioni:


1. Prof. dr. Arbnor Pajaziti

 - kryetar

2. Prof. dr. Mirlind Bruçi

 - mentor, anëtar

3. Prof. asoc. Dr. Xhevahir Bajrami

 - anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.